

# TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

## Përmbajtja

- I. Seminari i të premtes
- II. Punët kërkimore të sapopërfunduara
- III. Materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj
- V. Aktivitete të tjera

## I. SEMINARI I TË PREMTES

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2013, materialet e prezantuara në aktivitetin kërkimor “Seminari i të premtes” kanë trajtuar tematika që kanë të bëjnë me rolin e politikës fiskale në Bashkimin Evropian (BE), me sinkronizimin e cikleve të biznesit, rolin e bankave dhe ndikimin e ndërlidhjeve midis tyre, kulturën financiare të individëve në Shqipëri dhe impaktin e trendit stokastik në luhatjet ekonomike etj. Në rubrikën më poshtë do të gjeni një përmbledhje më të detajuar të këtyre materialeve.

### **“QËNDRUESHMËRIA FISKALE NË BASHKIMIN EVROPIAN (BE) DHE VENDET E TJERA KANDIDATE TË MUNDSHME”, NGA GERTI SHIJAKU, (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material ka në fokus vlerësimin e tipareve të kthimit të raportit të borxhit ndaj PBB-së drejt mesatares historike në afatin e gjatë, në 27 vendet anëtare të BE-së dhe ato candidate, për periudhën 2000–2011. Punimi shqyrton kushtin e

aftësisë së shlyerjes nëpërmjet teknikave të testit të rrënjës njësi dhe vlerëson funksionin e reagimit të politikës fiskale të vendeve të marra në shqyrtim me anë të metodës VAR për të dhëna në panel. Vlerësimet e marra tregojnë që politika fiskale shfaq inerci të konsiderueshme në sjelljen e saj, si dhe autoritetet fiskale reagojnë sistematikisht ndaj rritjes së raportit të borxhit, duke gjeneruar suficite të ardhshme.

### **“SINKRONIZIMI I CIKLEVE TË BIZNESIT: NJË MATJE E INTEGRIMIT PËR VENDET E EUROPËS JUGLINDORE”, NGA ENDRIT YZEIRAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material synon të masë nivelin e integritit të ekonomive rajonale, të vlerësuar me anë të treguesve makroekonomikë dhe bazuar në metodologjinë e dekompozimit të krijuar nga Blanchard dhe Quah (1989) për VAR-in strukturor. Rezultatet tregojnë se goditjet nga ana e ofertës dhe kërkesës

për ekonomitë rajonale janë të dobta, si dhe goditjet e kërkesës janë më të sinkronizuara se ato të ofertës. Një ndër faktorët shpjegues të këtyre gjetjeve lidhet me rolin që ka kanali tregtar, përkundrejt kanaleve të tjera strukturore.

**“IMPAKTI I TRENDIT STOKASTIK TË RITJES NË LUHATJET EKONOMIKE NË SHQIPËRI”, NGA BLEDAR HODA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material analizon karakteristikat e treguesve kryesorë makroekonomikë në kuadër të modeleve të ciklit të biznesit. Materiali shqyrton nëse ato janë konsistentë me rritjen e balancuar të drejtuar nga produktiviteti, si dhe vlerëson rolin që luan cikli dhe trendi stokastik në rritjen ekonomike të vendit. Bazuar në modelin strukturor të korigjimit të gabimeve, vlerësohet se goditjet permanente të drejtuara nga trendet stokastike shkaktojnë më shumë luhatje përkundrejt trendit gjeneruar nga metodat standarte të filtrave statistikore.

**“EFEKTI I KURBËS-J. NDIKIMI I KURSIT TË KËMBIMIT NË BILANCIN TREGTAR DYPALËSH NDËRMJET SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE KRYESORË TREGTARË”, NGA ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material trajton ndikimin e kursit të këmbimit në shkëmbimet tregtare dypalëshe të Shqipërisë me partnerët e saj kryesorë si: Eurozona, Italia, Greqia, Gjermania dhe Turqia, me qëllim vlerësimin e ekzistencës së “kurbës-J” në tregtinë dypalëshe për periudhën 1998-2012. Nëpërmjet “Metodës së korigjimit të gabimit” (*Error Correction Model*) evidentohen efektet afatshkurtra dhe afatgjata që ka

nënçmimi i monedhës vendase në bilancin tregtar dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë.

**“MODELI FINANCIAR PËR SHQIPËRINË: NJË PËRQASJE ME TË DHËNA NË PANEL”, NGA ELONA DUSHKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VASILIKA KOTA (DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR).**

Materiali ka për qëllim prezantimin e një modeli financiar për Shqipërinë bazuar në analizën e detajuar të bilanceve të 16 bankave që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri. Modeli përmban gjithsej 35 ekuacione, nga të cilat 8 janë ekuacione të vlerësuar dhe 27 janë identitete. Variablat e vlerësuar me anë të metodës me panel janë: vëllimi i kredisë (ndarë për individët dhe bizneset), të ardhurat neto nga interesi, risku i aktivitetit të kredisë, norma e kredive të këqija (ndarë për individëve dhe bizneseve), norma e interesit të kredisë, si dhe kostoja e kredisë. Analiza e simulimeve dhe e goditjeve të ndryshme vlerëson transmetimin e mekanizmit të modelit në treguesit e shëndetit bankar, si dhe impaktin në ekonominë reale të vendit.

**“GLOBALIZIMI, REGJIMET E KURSIT TË KËMBIMIT DHE KONTAMINIMI FINANCIAR”, NGA BRANKO UROŠEVIĆ (BANKA QËNDRORE E SERBISË).**

Kriza e fundit financiare dëshmoi për brishtësinë e arkitekturës financiare ndërkombëtare duke nxjerrë në pah dy çështje mjaft të rëndësishme nga pikëpamja e stabilitetit financiar: nivelin optimal të ndërlidhjeve financiare dhe përcaktimin e regjimit të përshtatshëm të kursit të këmbimit midis vendeve, për të siguruar në këtë mënyrë stabilitetin financiar të shumë

vendeve së bashku. Materiali mbështet dhe i adreson çështjet e ngritura më sipër në kuadër të modelit D-D, duke i vlerësuar njëkohësisht fenomenet e lartpërmendura.

**“DUKE PARË MBI ASPEKTE TË TJERA TË PBC (CIKLET POLITIKE TË BIZNESIT): CIKLET POLITIKE TË BIZNESIT DHE PRITSHMËRITË” NGA DRINI IMAMI (UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS), HOLGER KÄCHELEIN (QENDRA E EVROPËS JUGLINDORE PËR ZHVILLIM EKONOMIK) DHE ENDRIT LAMI (KANDIDAT PËR PHD NË UNIVERSITETIN E BUDAPESTIT).**

Materiali analizon ciklet politike të biznesit në Shqipëri dhe vlerëson impaktin e tyre në tregues të ndryshëm makroekonomikë bazuar në modelet ARMA. Rezultatet tregojnë që pritshmëritë më të mira për rritje ekonomike para zgjedhjeve politike dhe pritshmëritë mbi impaktin e tyre mbas zgjedhjeve mund të ndikojnë vendimet e firmave të sektorit privat.

**“ROLI I PARASË SI NJË SHTYLLË E RËNDËSISHME PËR POLITIKËN MONETARE: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA GERTI SHIJAKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Fokusi kryesor i këtij materiali është vlerësimi i funksionit të kërkesës për para dhe të shpejtësisë së qarkullimit të parasë së gjerë, M3 në afatin e mesëm dhe të gjatë, duke patur parasysh rolin e saj si një shtyllë e dytë e rëndësishme për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë. Rezultatet tregojnë se kërkesa për para është e qëndrueshme edhe pas krizës financiare dhe ekonomike, si dhe ecuria e saj përmban informacion të rëndësishëm për ecurinë e inflacionit.

**“PERFORMANCA E PARASHIKIMIT TË INFLACIONIT DHE VENDIMARRJA E POLITIKËS MONETARE GJATË 2011-2012” NGA EVELINA ÇELIKU DHE GENTI HASHORVA (DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE).**

Studimi analizon ecurinë e procesit parashikues të inflacionit dhe të rolit të tij në vendimmarrjen e politikës monetare të Bankën e Shqipërisë, gjatë periudhës 2011-2012. Në material evidentohen sfidat kryesore më të cilat përballet projeksioni, kryesisht në periudha të pasigurive të larta ekonomike, duke u fokusuar në inflacionin e publikuar, parashikimet e bëra, pritshmëritë dhe rëndësinë e tyre për formulimin e politikës monetare.

**“KULTURA FINANCIARE NË SHQIPËRI: REZULTATET E VROJTIMIT PËR MATJEN E NIVELIT TË NJOHURIVE FINANCIARE TË POPULLATËS, 2011”, NGA KLITI CECA, BORANA HAXHIMUSAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), ARLINDA KOLENIÇO DHE EGNIS ISAKU (DEPARTAMENTI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE KOMUNIKIMIT).**

Materiali paraqet rezultatet e marra nga “Vrojtimi për matjen e kulturës financiare të popullatës në Shqipëri, gjatë vitit 2011”, organizuar për herë të parë nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën e Italisë. Rezultatet e këtij vrojtimi paraqesin disa nga tendencat kryesore mbi njohuritë financiare të zotëruara nga individët, mbi sjelljet dhe qëndrimet e mbajtura prej tyre mbi aspekte të ndryshme të administrimit të financave personale apo familjare në Shqipëri.

## II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

**“KULTURA FINANCIARE NË SHQIPËRI: REZULTATET E VROJTIMIT PËR MATJEN E NIVELIT TË NJOHURIVE FINANCIARE TË POPULLATËS, 2011”, NGA KLITI CECA DHE BORANA HAXHIMUSAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), ARLINDA KOLENIÇO DHE EGNIS ISAKU (DEPARTAMENTI I MARËDHËNIEVE ME JASHTË, INTEGRIMIT EVROPIAN DHE KOMUNIKIMIT.**

Në krijimin dhe përshtatjen e programeve edukuese, rol të rëndësishëm luan edhe identifikimi i mangësive dhe gjetja e mënyrave të duhura për një përjasje sa më eficiente ndaj nevojave reale të publikut. Për këtë arsye u krye “Vrojtimi për matjen e kulturës financiare të popullatës, 2011”, i cili ishte një ndër aktivitetet e parashikuara në kuadër të projektit të binjakëzimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Italisë, financuar nga Bashkimi Evropian. Rezultatet e tij hedhin dritë mbi përfshirjen financiare, mbi njohuritë financiare të zotëruara, mbi sjelljet e ndjekura, si dhe qëndrimet e mbajtura nga individët shqiptarë të anketuar, lidhur me aspekte të ndryshme të administrimit të financave personale apo familjare. Pikërisht për këtë arsye, ai përbën një element kyç për përcaktimin dhe vijëzimin e çështjeve që do të adresohen në strategjinë për rritjen e kulturës financiare në vend.

**“VLERËSIMI I SERIVE ME FREKUENCË MË TË LARTË ME METODËN KALMAN: GJENERIMI I SERIVE TREMUJORE TË DEFLATORËVE TË TREGTISË, PBB-SË, KONSUMIT DHE INVESTIMEVE NË SHQIPËRI”, NGA BLENDAR HODA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Vlerësimi metodologjik i serive më frekuencë më të lartë (tremujore) është jo vetëm një nevojë për zgjerimin e fushës kërkimore në Bankën e Shqipërisë por edhe një kusht për punë kërkimore cilësore. Në këtë punim informacioni më frekuencë vjetore (nga burime alternative) përdoret për gjenerimin e serive tremujore në rastin e treguesve ekonomikë me interes, të cilët nuk janë të disponueshëm në frekuencën e nevojshme. Me anë të metodës së filtrimit Kalman në formatin e ekuacioneve të gjendjes (*state space*) arrihet të prodhohen seritë tremujore të deflatorëve të tregtisë, PBB-së, konsumit dhe investimeve (reale dhe nominale) për periudhën kohore për të cilën seritë vjetore janë të disponueshme (1996-2012 për deflatorët e tregtisë dhe 1993-2012 për llogaritë kombëtare). Për të përmirësuar cilësinë e serive të prodhuara përdoren tregues monetarë, fiskalë ose të bilancit të pagesave, të cilët mbartin informacion shtesë mbi treguesit e vlerësuar.

### III. MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

#### **“VLERËSIME STATISTIKORE TË TREGUESVE EKONOMIK, LIDHUR ME TEKNIKA TË VLERËSIMIT TË DENSITETEVE”, NGA ALTIN TANKU DHE KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material ka për qëllim propozimin e një metode alternative të perceptimit dhe vlerësimit empirik të fenomeneve ekonomike bazuar në metodën e vlerësimit të densiteteve. Metodologjia kryesore e paraqitur në këtë material është metoda e modelimit të variablave të rastit (skalare dhe vektoriale), që konsiston në vlerësimin e densiteteve shumë përmasore. Gjithashtu synohet edhe realizimi i goditjeve të këtyre densiteteve me anë të kushteve 1 (një) dhe shumë përmasore sipas disa variableve. Zbatimi empirik është bërë mbi përzgjedhjen e disa variablave të njëjtë makroekonomike si PBB, inflacioni, treguesit monetar etj. për disa ekonomi të zhvilluara. Kjo mënyrë vlerësimi do të shërbejë për të gjykuar nga një këndvështrim alternativ modelimin dhe ndërveprimin e variablave të caktuara makroekonomike.

#### **“GJENERIMI I SERISË SË KONSUMIT DHE INVESTIMEVE PRIVATE ME FREKUENCË TREMUJORE DHE ESKTRAPOLIMI I TYRE DERI NË VITIN 2012”, NGA SEKTORI I MODELIMIT MAKROEKONOMIK (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Në kuadër të rivlerësimit të modelit makroekonomik MEAM, një element kyç është azhornimi i databazës së modelit me frekuencë tremujore deri në vitin

2012. Kjo është një detyrë sfiduese, duke patur parasysh që disa tregues të kërkesës agregate janë të disponueshëm deri në vitin 2008 dhe me frekuencë vjetore. Ky material përdor specifikime të ndryshme të modeleve ADL (Autoregressive Distributed Lag) për të ekstrapoluar serinë e konsumit dhe investimeve private deri në vitin 2012, si dhe për t'i interpoluar këto seri në frekuencë tremujore. Regresionet e përdorura janë bivariate, ku variabli i varur (konsumi/investimet private) shpjegohet nga një tregues udhëheqës apo që e shoqëron atë në të njëjtën periudhë. Identifikimi i këtyre treguesve është bërë sipas logjikës ekonomike, historikut të tyre, statistikave deskriptive, si dhe gjyqimit të ekspertëve. Specifikimet më të mira të ADL-së janë përzgjedhur më pas mbi bazën e testeve diagnostike të vlerësimit dhe të parashikimit. Në fund, rezultatet e modeleve të përzgjedhura janë ponderuar sipas rrënjës katrore të mesatares së gabimeve për secilin specifikim për të gjeneruar një vlerësim të vetëm për secilin, konsumin dhe investimet private të ekonomisë shqiptare.

#### **“PROBABILITETI I NDALIMIT TË PAPRITUR: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA GERTI SHIJAKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky studim ka si qëllim kryesor i të analizoj flukset e kapitalit të huaj bazuar në konceptin e episodeve të 'ndalimit të papritur'. Së pari, autori ndërton një tregues të ndalimit të papritur (tregues binar) për të analizuar lëvizjet në flukset e kapitalit të huaj. Së dyti, probabiliteti i këtyre episodeve vlerësohet si funksion

i treguesve ekonomikë, duke vlerësuar një model probit me të dhëna tremujore që mbulojnë periudhën 2004 – 2012. Analiza empirike tregon se probabiliteti i këtyre episodeve ndikohet negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme statistikiisht nga rritja ekonomike e vendit, dhe pozitivisht nga rreziku që shoqëron politikat fiskale dhe ato të borxhit. Gjithashtu zhvillimi dhe integrimi i mëtejshëm financiar i vendit e bën Shqipërinë më të ndjeshëm ndaj episodeve të shkaktuara nga investitorët vendas ose të huaj.

**“EUROIZIMI FINANCIAR. PASOJAT E MUNDSHME DHE KUJDESI NDAJ TIJ”, NGA LINDITA VRIONI (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material fokusohet në analizimin e euroizimit të lartë të sistemit financiar në Shqipëri dhe ndikimin e tij në procesin e vendimarrjes së politikës monetare. Analizimi i shkallës së euroizimit financiar në Shqipëri është parë në tre dimensione: euroizimin e depozitave, euroizimin e kredive dhe euroizimin real, duke paraqitur faktorët që ndikojnë në këtë nivel si dhe ndikimet e mundshme në ekonomi. Materiali del në përfundimin se masat më të kujdesshme janë ato që do të inkurajonin përdorimin më të madh të lekut sesa masat për de-euroizim.

**“ROLI I TREGUESVE NOMINALË NË CIKLET E BIZNESIT DHE RRRITJEN EKONOMIKE”, NGA BLENDAR HODA, (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Luhatjet e prodhimit të brendshëm dhe ritmi i rritjes ekonomike janë në fokusin e bankave qendrore në të gjitha ekonomitë, ku identifikimi dhe roli i goditjeve nominale (të normës së interesit dhe faktorit monetar)

në luhatjet e PBB-së janë kthyer në tema të nxehta. Në qendër të vëmendjes është potenciali i këtyre të fundit për të minimizuar luhatjet në rritjen ekonomike dhe për të shpjeguar përse ndodhin ato. Materiali synon të identifikojë rolin e këtyre faktorëve (normave të interesit dhe faktorit monetarë) në një sistem funksionesh kryesore makroekonomike të raporteve konsum-prodhim, investime – prodhim dhe funksionit të kërkesës për para. Gjetjet synojnë të evidentojnë domethënien e këtyre ndikimeve për të ndikuar në stabilizimin e hendekut të prodhimit.

**“VLERA THEMELORE E BANESAVE: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA ENDRIT YZEIRAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE).**

Ky material studimor synon vlerësimin e luhatjeve në çmimet e tregut të banesave në Shqipëri, duke u bazuar mbi një vlerë themelore të tyre si pasojë e treguesve të tjerë makroekonomik. Studimi ofron si risi ndërtimin e një indeksi me qëllim matjen e vlerës “reale” të banesave, në bazë të variablave themelore (*fundamentals*) të ekonomisë. Në këtë studim përdoret modeli ekonometrik VECM për të parë ndërlidhjen ndërmjet vlerave reale dhe atyre themelore të përcaktuara nga treguesit e tjerë.

**“INSTRUMENTAT E PAGESAVE SIPAS PERCEPTIMIT TË KONSUMATORËVE SHQIPTARË; REZULTATE NGA NJË ANKETË PUBLIKE”, NGA ALBAN PLLAHA, KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMIT TË PAGESAVE).**

Ky material studimor përdor të dhënat e përftuara nga "Anketimi i perceptimit të instrumenteve të pagesave sipas individëve" për të vlerësuar empirikisht arsyet që ndikojnë konsumatorët në përdorimin ose jo të tyre. Materiali përdor metodën "probit" për të evidentuar karakteristikat e konsumatorëve, të cilat

janë statistikisht të rëndësishme dhe kanë një ndikim domethënës në përdorimin e instrumentave të pagesave. Gjetje të studimit sugjerojnë se disa tipare si: niveli i edukimit, niveli i të ardhurave, gjinia etj. kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në përdorimin e instrumenteve të caktuara të pagesave nga konsumatorët shqiptarë.

#### IV. ARTIKUJ

Në këtë rubrikë do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të disa prej artikujve dhe materialeve kërkimore të publikuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe nga banka të tjera qendrore gjatë periudhës janar -qershor 2013, për të dhënë një këndvështrim mbi temat kërkimore - shkencore të publikuara gjatë kësaj periudhe.

#### **"STATUS QUO-JA" E SME-VE NË SHQIPËRI", NGA ELONA DUSHKU DHE ALBAN PLLAHA, (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), BOTUAR NË BULETIN EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË, GJASHTËMUJORI I PARË I 2013.**

Ky artikull ka për qëllim analizimin dhe studimin e SME-ve në Shqipëri gjatë periudhës 2006-2011, duke patur parasysh rëndësinë dhe rolin e SME-ve në rritjen e punësimit dhe në ekonomi. Identifikimi i tendencave kryesore është mbështetur kryesisht në analizimin e gjashtë treguesve kryesorë marrë nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve që janë: numri i ndërmarrjeve, numri i të punësuarve, vlera e shtuar, produktiviteti i punës, norma e fitimit dhe prirja e tyre për të investuar. Rezultatet tregojnë që

SME-të në Shqipëri kanë ndikuar në rritjen e numrit të të punësuarve dhe të vlerës së shtuar në ekonomi, gjatë periudhës 2006-2011, duke siguruar gjithashtu vlera pozitive fitimi në kohë. Prandaj, mbështetja dhe hartimi i politikave të përshtatshme mbetet si sfidë e ardhshme, për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

#### **"PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE NGA INDIVIDËT DHE BIZNESET. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI DY STUDIME TË BANKËS SË SHQIPËRISË", NGA KLITI CECA, ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMIT TË PAGESAVE), BOTUAR NË REVISTËN BANKIERI, NR. 8.**

Artikulli ofron një përmbledhje të përgjithshme mbi gjetjet kryesore të dy anketimeve publike, realizuar nga Banka e Shqipërisë, gjatë periudhës shkurt – mars, 2012, mbi perceptimin e instrumenteve të pagesave nga individët dhe bizneset. Në artikull evidentohen tiparet kryesore të instrumenteve të pagesave sipas perceptimit të individëve dhe bizneseve. Një nga gjetjet kryesore të këtyre dy anketimeve është: Bizneset

dhe konsumatorët shqiptarë perceptojnë se informacioni i tyre për disa nga instrumentet e pagesave në qarkullim është i kufizuar. Kjo thekson nevojën e thellimit të edukimit financiar për rritjen kulturës së kësaj fushe dhe kthimin të saj në një kulturë të përgjithshme.

Gjithashtu një pjesë e mirë e bizneseve shprehet se adoptimi i këtyre instrumenteve pagesash është një nevojshmëri në ditët e sotme. Aktualisht mungon kërkesa nga konsumatorët për ofrimin e këtyre mjeteve të pagesës por bizneset shprehen të gatshme t'i ofrojnë këto mjete pagesash nëse do të ketë një kërkesë më të lartë nga klientët e tyre.

[http://www.aab.al/bankieri/8/Bankieri\\_8\\_alb.pdf](http://www.aab.al/bankieri/8/Bankieri_8_alb.pdf)

## **KËRKIMI NË BANKAT E TJERA QËNDRORE.**

### **“PËRFSHIRJA E BANKËS QENDRORE NË MBIKËQYRJEN MAKROPRUDENCIALE”, NGA DANIEL GŁUCH, LUCIA SKOVRAOVÁ DHE MIKAEL STENSTRÖM (BANKA QENDRORE EVROPIANE).**

Ky studim trajton rregullimet institucionale për kryerjen e mbikëqyrjes makroprudenciale të sistemit financiar në Bashkimin Evropian, me fokus në funksionet e bankave qendrore. Studimi përshkruan rolin mbështetës që luan Banka Qëndrore Evropiane dhe bankat qendrore kombëtare në realizimin e funksioneve të ESRB-së (European Systemic Risk Board), si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen makroprudenciale të BE-së. Kjo mbështetje konsiston në çdo fazë të procesit të mbikëqyrjes makroprudenciale

ku përfshihet: (i) monitorimi i rrezikut nga mbledhja e të dhënave të rrezikut; (ii) identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut nga rishikimet analitike të infomacionit të mbledhur; dhe (iii) zvogëlimi i rrezikut si rezultat i paralajmërimeve, dhe i rekomandimeve të ndryshme për shmangien/ minimizimin e tij. Gjithashtu, studimi ofron një përmbledhje të modeleve aktuale që përdoren për të lehtësuar komunikimin në nivel kombëtar, ndërmjet autoriteteve kombëtare makroprudenciale dhe bankave qendrore përkatëse.

<http://www.ecb.int/pub/pdf/scplps/ecblwp14.pdf>

### **“STIMULI FISKAL NË KOHËN E BORXHIT TË LARTË: SHUMËZUESIT E RIKONSIDERUAR DHE DEFICITET BINJAKE”, NGA CHRISTIANE NICKLE DHE ANDREAS TUDYKA (BANKA QENDRORE EVROPIANE).**

Ky material hulumton ndikimin e stimulit fiskal në nivele të ndryshme të borxhit qeveritar ndaj PBB-së, për një kampion prej 17 vendeve evropiane, nga viti 1970 deri në 2010. Hulumtimi është realizuar nëpërmjet një kuadër paneli ndërveprues VAR, në të cilin parametrat e koeficientëve janë lejuar të ndryshojnë vazhdimisht me raportin e borxhit ndaj PBB-së. Studimi gjen se reagimet ndaj goditjeve në shpenzimet qeveritare kanë një sjellje të fortë jo-lineare. Ndërkohë që efekti kumulativ në PBB ndaj një goditje në shpenzimet qeveritare është pozitiv dhe i rëndësishëm në nivele të moderuara të raportit të borxhit ndaj PBB-së, ky efekt bëhet negativ kur raporti borxh ndaj PBB-së rritet.

<http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecbwp1513.pdf>



**“RISHIKIMI I PRODHIMIT POTENCIAL: PËRFSHIRJA E INFORMACIONIT ME CIKLIN FINANCIAR”, NGA CLAUDIO BORIO, PITI DISYATAT DHE MIKAEL JUSELIUS (BANKA PËR RREGULLIMIN NDËRKOMBËTAR, BIS).**

Ky studim argumenton se përfshirja e informacionit rreth ciklit financiar është i rëndësishëm në përmirësimin e matjes së prodhimit potencial dhe të hendekut të prodhimit. Nëpërmjet një kuadri të thjeshtë dhe transparent, studimi gjen se përfshirja

e informacionit rreth ciklit financiar mund të japë matje të prodhimit potencial dhe të hendekut të prodhimit që janë të vlerësuar në mënyrë më korrekte dhe gjithashtu shumë më të “forta” në kohë reale. Gjithashtu rezultoi se përfshirja e informacionit financiar ka dhënë vlerësime më të besueshme në lidhje me balancat buxhetore të axhustuara ciklikalisht, duke shërbyer si udhëzues i dobishëm për politikën monetare.

<http://www.bis.org/publ/work404.pdf>

## V. AKTIVITETE TË TJERA

### SEMINAR TEKNIK.

Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, organizon brenda departamentit, Seminarin Teknik dhe /ose seminare me karakter informues mbi çështje, dukuri apo fenomene të ndryshme në lidhje me ekonominë, financat etj. Në paragrafin më poshtë do të gjeni një përmbledhje të seminareve të zhvilluara gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2013.

### “ETIKA NË KËRKIMIN SHKENCOR”, NGA MARGERITA TOPALLI.

Materiali i prezantuar në këtë seminar kishte për qëllim trajtimin e çështjeve etike gjatë kërkimit shkencor dhe publikimit të tyre, për të garantuar origjinalitetin e punimeve dhe për të parandaluar publikimin e punëve kërkimore të papërgjeshme. Është e natyrshme që një publikim i mirë duhet të ketë rezultate të

reja, të dobishme, ku cilësia e lartë është element bazë për çdo publikim shkencor. Këto elemente eliminohen në sajë të profesionalizmit dhe etikës së gjithsecilit në çdo punë kërkimore. Disa nga çështjet kryesore të trajtuara në këtë prezantim kishin të bënim me: autorësinë, kopjimin (plagjaturën), vlerësimin dhe recensën e bëra nga të tjerët, (përfshirë edhe kolegët), si dhe menaxhimin e të dhënave.

### “ANALIZA INPUT-OUTPUT”, NGA ENIAN ÇELA.

Qëllimi i këtij seminari teknik ishte prezantimi dhe paraqitja mbi modelin dhe analizën *input-output*. Këto modele, të prezantuar fillimisht nga Leontief (1936) dhe të zhvilluar më vonë nga të tjerë, përfaqësojnë ndërlidhjet midis degëve të ndryshme të ekonomisë së një vendi apo mbi ato të ekonomive të ndryshme rajonale bazuar në supozimin që proporcionet e inputeve të përdorura midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë

janë fikse dhe nuk shfaqin ndryshime të rëndësishme në afatinin e shkurtër. Në seminar u paraqit mënyra e llogaritjes së koeficienteve teknikë dhe multikatorëve përkatës për prodhimin, të ardhurat dhe punësimin. Gjithashtu, u prezantuan mënyra e dhënies së goditjes, mekanizmi i transmetimit të këtyre modeleve dhe disa përdorimeve të mundëshme që ofron modeli *input-output*.

### **“TESTET E RRËNJËS NJËSI PËR TË DHËNAT NË PANEL” NGA ALTIN TANKU.**

Gjatë dekadës së fundit, ekonomistët i kanë kushtuar një punë të konsiderueshme teorike dhe empirike testeve të rrënjës njësi në të dhënat me panel. Pjesa kryesore e këtyre testeve për të dhënat me panel është dizenuar për të testuar hipotezën bazë për praninë e rrënjës njësi për çdo seri individuale në panel, ndërsa formulimi i hipotezës alternative është një çështje akoma e debatueshme, supozimet e të cilave mbartin natyrën e homogjenitetit apo heterogjenitetit të të dhënave në panel. Në këtë seminar u prezantuan disa nga testet e rrënjës njësi, si LLC (Levin, Li dhe Chu), Hadri, Fisher-ADF etj. duke dhënë një përmbledhje të shkurtër mbi ndryshimet kryesore të testeve panel perkundrejt atyre individuale.

### **“MODELET ME VARIABLA TË VARURA TË LIMITUARA”, NGA ENDRIT YZEIRAJ.**

Modelet me variabla të varura të limituara, kryesisht ato ku variablat marrin vlerat 0 dhe 1, përdoren shpesh në literaturën empirike. Ato përdoren kryesisht në trajtimin e problemeve mikroekonomike, gjithsesi gjejnë përdorim edhe përtej tyre. Në seminarin

mbi këtë punim u prezantua një përmbledhje e këtyre modeleve, duke u fokusuar kryesisht mbi modelin logit, që përdor shpërndarjen probabilitare logjistike për të kryer modelimin, si dhe në paraqitjen dhe vlerësimin e tyre në programin Stata.

### **“ICAAP – PROCESI I VLERËSIMIT TË KAPITALIT TË BRENDSHËM TË BANKËS. SHTYLLA E DYTË”, NGA LINDITA VRIONI.**

Ky material kishte për qëllim prezantimin e metodës vlerësuese ICAAP (Internal Capital Adequacy Assessment Process), në kuadër të zbatimit të Basel II, identifikimin e ndryshimeve me metodën standarte të vlerësimin të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe mënyrën e së vlerësimin të rreziqeve përmes metodës ICAPP. Gjatë seminarit u trajtua edhe koncepti i kapitalit ekonomik dhe procesi i vlerësimin të tij, i parë nga perspektiva e një banke individuale. Gjithashtu u përmendën disa nga qasjet e ndryshme të ofruara nga kuadri rregullativ i Basel II si dhe përmirësimet e proceseve/ metodave të vlerësimin të rrezikut, të ndërmarra pas krizës financiare.

### **ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË, PËR VITIN 2013.**

Për të 8-in vit radhazi Banka e Shqipërisë organizon konkursin “Çmimi i Guvernatorit për diplomën më të mirë” për vitin 2013. Ky çmim inkurajon studentët shqiptarë të diplomuar gjatë këtij viti, brenda dhe jashtë vendit, të konkurrojnë me punë shkencore mbi çështje të lidhura me ekonomiksion monetar, stabilitetin financiar, integrimin

ekonomik të Ballkanit në Evropë, veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë në përgjithësi. Konkursi, i kthyer tashmë në një traditë të Bankës, ndihmon krijimin e një kulture kërkimi shkencor dhe të një strukture mbështetëse me studiues të rinj, të cilët nuk kanë vetëm dëshirën, por edhe njohuritë e nevojshme për të studiuar.

Afati i dorëzimit të materialeve është data 28 shtator 2013.

Informacion më të detajuar mbi rregullat e pranimit të materialeve Ju lutem mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm;

[http://www.bankofalbania.org/web/mimi\\_i\\_Guvernatorit\\_per\\_Diplomen\\_me\\_te\\_Mire\\_2013\\_6560\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/mimi_i_Guvernatorit_per_Diplomen_me_te_Mire_2013_6560_1.php)

## WORKSHOPI I 7 I KËRKIMEVE NË EVROPËN JUG-LINDORE.

### FTESË PËR PJESËMARRJE.

Banka e Shqipërisë organizon gjatë muajit nëntor<sup>1</sup>[1] "Takimin e 7 -të Rajonal Kërkimor në Evropën Juglindore", me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis studiuesve dhe hartuesve të politikave makroekonomike në rajon, thellimin dhe zgjerimin e njohurive mbi karakteristikat e ekonomive në rajon, si dhe njohjen mbi politikat makroekonomike dhe makroprudenciale të tyre. Çështjet kryesore që ky takim synon të trajtojë janë si më poshtë:

Impakti mbi rregullat makro-financiare, bashkimin dhe mbikëqyrjen bankare në Eurozonë dhe në vendet e CESEE-së;

Model i ri në politikën dhe aspektet praktike të ndjekura nga banka qendrore;

- *Roli i informacionit makro dhe mikroekonomik në analizat ekonomike, një model i ri në modelimit makroekonomik;*
- *Historia e mendimit dhe zhvillimit ekonomik;*
- *Modelimi i procesit të vendimmarrjes dhe politikave për zhvillimin e ekonomive në tranzicion;*
- *Ekuilibrat e jashtëm dhe të brendshëm dhe aplikimet (implikimet) për politikat ekonomike;*
- *Politikat e qeverisë për nxitjen e rritjes ekonomike dhe inovacioneve (risive).*

Banka e Shqipërisë fton të gjithë personat e interesuar për të marrë pjesë në këtë konferencë dhe që duan të kontribuojnë në fushën kërkimore, nëpërmjet dërgimit të materialeve të plota kërkimore, jo më vonë se data 14 tetor 2013, pranë drejtorit të Departamentit të Kërkimeve z. Altin Tanku ([atanku@bankofalbania.org](mailto:atanku@bankofalbania.org)) dhe Koordinatorës së Projekteve pranë Institutit të Studimeve Ekonomike dhe Bankare, zj. Borana Haxhimusaj ([bhaxhimusaj@bankofalbania.org](mailto:bhaxhimusaj@bankofalbania.org)).

<sup>1</sup> [1] Datat ekzakte të zhvillimit të aktivitetit do të publikohen në një moment të dytë

**LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:**

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Bank of Finland ([http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit\\_julkaisut/index.htm](http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm))

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Deutsche Bundesbank ([http://www.bundesbank.de/vfz/vfz\\_diskussionspapiere\\_2009.en.php](http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php))

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Oesterreichische Nationalbank ([http://www.oenb.at/en/presse\\_pub/research/research.jsp](http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp))

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)